

VENDIM
Nr. 519, datë 6.8.2014

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR APARATIN E KRYEMINISTRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e Kryeministrit , Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aparatit të Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, t’i shtohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, në zërin “Shpenzime korrente”, për funksionimin e grupit Task-Forcë “Për verifikimin e ligjshmërisë dhe mënyrës së tjetërsimit të pronave të paluajtshme shtetërore, në kuptim të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondi i kontingjencës për vitin 2014.

3. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama